Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

283/20
12.06.20

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	13.05.2019	*12.06.2020*	283/20
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë 07.05.2020, OE :" **Sib-bka**", ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.**283/20** në lidhje me aktivitetin e prokurimit **"Hartimi I projekteve të ndërtimit të ulët"** me nr. të prokurimit: **632-20-211-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Gjakovë.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Autoriteti Kontraktues ka kerkuar ne kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2

Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën e ATK-së tëpaktën këtë stafprofesional të paraqitur në 3 (tri) vitet e fundit dhe deri me tani.

- një projekt menaxher (inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi konstruktive apo infrastrukturë rrugore) me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 15 vite përvojë pune.

- një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi konstruksion apo infrastrukturë rrugore - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 5 vite përvojë pune.

- një inxhinier i diplomuar në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi arkitekturë me përvojë pune në projektim, së paku 5 vite përvojë pune.

- një inxhinier të diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi hidroteknike - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 5 vite përvojë pune.

- një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri elektroteknike - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 5 vite përvojë pune.

- një inxhinier i gjeodezisë ose bachelor i inxhinierisë së ndërtimit dhe arkitekturës

drejtimi gjeodezi me përvoje pune profesionale minimum 5 vite;

- një bachelor të ndërtimtarisë drejtimi konstruksion apo infrastrukturë rrugore - me përvojë pune profesionale minimumi 5 vite; - një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi infrastrukturë rrugore - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 1 vite përvojë pune.

AK komuna e Gjakoves ka sjell nje vendim lidhur me kerkesen tone per rivleresim te kushteve te tenderit ne te cilin thekson si pjeserisht te drejte kerkesen tone per rishqyrtim por te njetit nuk merren me permiresimin e kushteve te tenderit. Prandaj jemi detyruar qe te kerkojme nga OSHP shqyrtimin e kytere pretendimeve si ne vijim:

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues, duke kerkuar qe i gjithe stafi - menagjeri përfshi dhe gjashte inxhinier te jene te paraqitur ne ATK (i punësuar pranë ofertuesit minimum tre vitet e fundit!?) shkel ligjin e prokurimit ne nenin 1,6 dhe 7, duke krijuar kushte per konkurrence jolojale, dhe duke ngushtuar afitesine konkurruese permes kushteve te cilat nuk ndihmojne ne marrjen e sherbimeve kualitative. Nese inxhinieret kane qene te punesuar ne ndonje kompani tjeter dhe kane pervojen e mjaftueshme pse mos te kerkohet deshmia e te njetit-qofte edhe permes paraqitjes ne ATK ne kompanin ku ka ushtruar profesionin me heret, por jo detyrimisht i punesuar tre vitet e fundit te ofertuesi!? Sa i perket kerkeses: *- një bachelor të ndërtimtarisë drejtimi konstruksion apo infrastrukturë rrugore - me përvojë pune profesionale minimumi 5 vite; - një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi infi-astrukturë rrugore - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 1 vite përvojë pune. AK eshte ne kundershtim me vetveten, nuk mund te kerkohet i punësuar ne konmpani tre vitet e fundit ndersa pervoja e kerkuar eshte 1 vitë pune?*

AK, sa i perket kesaj kerkese eshte ne kundershtim me vetveten. Nuk mund te jete i paraqitur ne ATK ne tre vitet e fundit nje punetore profesional i cili e ploteson kriterin e kerkuar me me se paku 1 vite pervoje pune!

Njekohesisht, bazuar ne ligjet e aplikueshme ne Kosove, punësimi i eksperteve te jashtem eshte i lejuar, duke themeluar mardhenje pune me afat të caktuar. Autoriteti Kontraktues limiton shfrytezimin e mundesive reale dhe ligjore per plotesimin e këti kriteri. Pra, këto kerkesa te AI< jane diskriminuese dhe tendencioze per pershtatje te OE te caktuar paraprakisht pa

asnje dyshim!!!

Kërkojme nga AK, ne kuader te kesaj kerkese per rishqyrtim te kritereve, te hiqet kushti qe i gjithe personeli te jene te paraqitur ne ATK e sidomos tre vitet e fundit vetem te ofertuesi, Të shtohet - per stafin qe nuk është i punesuar tek ofertuesi mund të paraqitet marreveshje punesimi mes paleve (me garanci te tjera shtese nese eshte e nevojshme), duke përmendur emrin dhe numrin e procedures se prokurimit.

Pretendimi 2

Personeli shtesë për këtë projekt

- një master i biologjisë (ose të ngjashëm), i licencuar për VNM (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis)
nga MMPH (nga viti kaluar i lajmëruar në ATK te ofertuesi)
- inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit) - i certifikuar për projektim të
udhëkryqeve me sinjale ndriçuese, i certifikuar për auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC. Përvoja e punës ti përgjigjet pozicionit 16 dhe 17 të paramasës. Përvoja e kërkuar së paku 5 vite (me kontratë origjinal të bashkangjitur edhe letërnjoftimin ose kontratë te noterizuar)

Eshte per tu habitur qe edhe te personeli shtesë u desh nje specifikim i till! Se pari nje master i biologjis (ose te ngjashem) i licencuar për VMN, por jo tre vitet e fundit ne ATK por nga viti i kaluai ! Kjo nuk eshte asgje me shume as me pak se sa pershtatje per Operator Ekonomik te caktuar
dhe diskriminim te OE te tjere. Kerkesa e till ne FDT ngushton edhe me shume mundesin konkuruese pa ndikuar ne marrjen e shërbimeve cilesore!

Ndërsa, kërkesa e specifikuar inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit), nuk mjafton per AK por duhet edhe certifikim per projektim te udhëkryqeve me sinjale ndricuese!
Nuk mjafton me kaq por duhet te jete dhe i certifikuar per auditim te siguris rrugore! Vlen te theksohet ky lloj certifikimi i kerkuar akoma nnk behet ne Republiken e Kosoves. Kjo, nuk eshte asgje me shume as me pak se sa pershtatje per Operator Ekonomik te caktuar dhe diskriminim
e OE te tjere. Kerkesa e till ne FDT, ngushton edhe me shume mundesin konkuruese pa ndikuar ne
marrjen e shërbimeve cilesore! Vlen te theksohet se ky ekspert mund te jete me kontrate dhe leternjoftim (sepse kete ekspert OE i favorizuar me keto kushte nuk e ka ne listen e ATK-se as per
nje vit sic e ka ekspertin me VMN), kjo eshte aq e thjesht per ta kuptuar !
Ne kete pretendim AI< ka intervenuar pjeserisht duke hequr vetem kushtin qe personi i lecencuar per VMN mund te mos jete i lajmeruar ne ATI< por te angazhohet me kontrate per Pune specifike,
ndersa sa i perket pikes lidhur me inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit)

- i certifikuar për projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese, i certifikuar për auditim të sigurisë
rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC. Përvoja e punës ti përgjigjet pozicionit 16 dhe 17 të
paramasës. Përvoja e kërkuar së paku 5 vite (me kontratë origjinal të bashkangjitur edhe letërnjoftimin ose kontratë te noterizuar)

AK ka mbetur ne pozicionin e me parshem qe eslite plotesisht diskriminues dhe tendencioz per te favorizuar **OE** te caktuar!

Autoriteti Kontraktues ka kerkuar ne kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2

Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën një instrunient GPS për matje gjeodezike-Instrumenti duhet të jetë i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike.

Pretendimi 3. Kerkesa per paisjet gjeodezike mund te mbulohet nga nje kompani projektuese nga nje nenkontraktor qe merret sepcifikisht me pune gjeodezike e ka bashkepunim sa i perket sherbimeve gjeodezik. Prandaj, kerkesa sa i perket ketyre paisjeve duhet te modifikohet sepse mund te plotesohet me një nenkontraktor.

Po ashtu edhe pretendimin 3 AK e ka vleresuar si te drejte dhe ka pranuar propozimin tone ne kerkesen per Rishqyrtim.

Operatori Ekonomik duhet te ketë zyre ne zonën urbane te qytetit te Gjakovës.

Pretendimi 4: Sa i perket ketkeses se AK, qe OE detyrimisht te kete zyre ne zonen urbane te Gjakovës sa eshte e pakuptimt, tendecioze dhe shume e turpshine. Kur bota sot dhe teknologjia e kominikimit ka arritur nivelet me te larta qe ka njohur njerzimi deri sot Komuna e Gjakoves detyron nje ndermrrje Projektuese profesionale te kete zyre dhe ate vetem ne zonen Urbane te qytetit! Nese duhen takime fizike e gjithe Kosova,maksimumin e arritjes prej cilit do vend te Kosoves ne Gjakove e ka nje ore e tridhjet minuta. Cili eshte qellimi i kesaj kerkese te AK!?

Pretendimi 5: AK ka paraqitur nje paramase per aplikim qe nuk ka te beje me profesionalizem. Ne gjuhen shkencore te ndertimit deri sot kemi mesuar per koncept projekt, projekt ideor, projekt kryesor, projekt rikonstruimi, projekt sanimi, projekt meremetimi, Por kesaj radhe nga AI< Kornuna e Gjakoves mesuam terminologji te pa qena! **Projekt i ri dhe ri projektim.** Sipas AK Komuna e Gjakoves paska edhe projektim te vjeter por ata ne tender e duan projekt te ri. Kjo paramase eshte e pakuptim dhe jep mundesi te shumta manipulative ne vendosjen e emimeve ne kete ofert e po ashtu mundeson interpretim te ndryshem ne fazen e imlementmit te kontrates.

Per ilustrim te ketij pretendimi po ju japim disa sqarime te pakuptimta lidhur me kete paramase:

Hartimi i Projekteve të Ndërtiuiit të Ulët				
RRUGËT, OBJEKTETE RRUGËS DHE HAPËSIRATPUBLIKE	Njesia matese	Projekt i Ri ku eshte c	Ri- Projektim allimi ??? J	Totali i i rrugët, ob dhe hapsë % e pikav
Projektimi i terreneve sportive (te hapura)	m^2			
Projektim i rrugëve në pjesën urbane - me dy shirita	m'		1	
Projektim i rrugëve në pjesën urbane - me tri shirita	m'		J	
»E[ojektim i rrugëve në pjesën urbane - me katër shirita '	m'			

Projektimi i trotuareve	m'			
*Projektimi i Rrugëve ne zonen Rurale - me dy shirita	m'			
Projektimi i Rrugëve ne zonen Rurale - me tre shirita	m'		cfare	
Projektimi i Rrugëve ne zonen Rurale - me kater shirita	m'		cmimesh te	
Matjet gjeodezike	m'/m²		vendosen ne	
Projektimi i Urave deri 10 m	m'		kete	
Projektimi i Urave mbi 10 m			kolon???	
ProjektTmi i Mureve Mbrojtese	m²			
Projektimi i udhëkryqeve	m'			
Numërimi i automjeleve (përcaktimi i nivelit të shërbimit për udhëkryqe dhe segmente te caktuara)	për automjet			
Projektimi i sinjalizimit te rrugëve (Horizontal dhe Vertikal)	m			
Projektimi dhe analizim i udhëkryqeve me sinjalizim ndriçues	m'			
Auditimi i sigurisë rrugore te rrugëve dhe objekteve ne rrugë	m'			
Projektimi i parkingjeve	m²			
Projektimi i parqeve dhe shesheve	m²			
Projektimi për VNM	m²			
Projekti i shpronesimit (elaboratet e shpronesimit)	m'			
Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik	m'			<
7) 8 - gjithsejt (1-18)		-	-	

Ku eshte dallimi ne mes te projektimit te nje rruge me dy, tre apo kater korsi ne zone urbane apo zone rurale??? Ku eshte dallimi ne mes poz. 13 dhe 16? Si mund te behet nje projekt i udhekryqit pa sinjalistike qofte ajo me ndricim apo pa te? Nuk mnund te behet asnje projekt perfshi dhe udhekryqin pa analize. Ku eshte dallimi ne mes te Projektit te Ri dhe Ri Projektimit !!!??? Cka ka dallim projektimi i nje ure deri ne 10 m dhe nje ure mbi 10 m qe te kene cmime te ndryshme per njesi? Cka ka dallim projektimi i nje ujesjellesi ne zone rurale dhe zone urbane, cka ka dallim projektimi i nje kanalizimi ne zone urbane apo zone rurale! Kjo paramase nuk eshte asgje tjeter pos edhe nje manipulim i radhes i institucioneve tona qe tani me joprofesionalizimin dhe manipulimet si keto po i konsiderojne vlerë!!!

Projektimi i rrugeve me dy,tre apo kater korsi nese projektohet ne zone rurale apo urbane nuk ka asnje dallim (rruget dallohen vetem nga kategorizimi qe percaktohet ne baze te parametrave te caktuar dhe shfrytzueshmeris se tyre). Pozicioni 13 dhe 16 nuk ka asnje dallim ka vetem dhe nje gabim shtese ne njesin e paraqitur m'. Poz. 14 hyne ne kuader te projektimit te rrugeve dhe kryqezimit te tyre. Nuk ka asnje dallim i projektimit te ujesjellesit e zone urbane e zone rurale, e as projektimi i kanalizimit ne zone urbane e zone rurale. Projekt i ri dhe Ri projektim eshte vetem nje MANIPULIM. Pra, te gjitha keto nuk jane me shume se joprofesionalizem dhe shpikje per te mundesuar abuzimin dhe vendosjen ne lajthitje te konkurenteve.

AI< komua e Gjakoves ne vendimin lidhur me kerkesen tone per Rishqyrtim ka bere disa intervenime shume siperfaqesore e nuk eshte marr me pretendimet baze si Pretendimi l(kerkese kjo qe stafi prej 7 inxhiniereve duhet te jete pjee e stafit e deklaruar ne ATK tre vitet e fundit!), Pjesa 2 e Pretendimit 2 , Pretendimin 4 dhe sidomos me Pretendimin 5.

Me ane te kesaj kerkese per rivleresim presim nga OSHP qe te anuloj kete procedur te prokurimit me verejtje per AK komuna e Gjakoves qe te eleminoj kushtet diskriminuese te paraqitura ne kete material tenderus, te perpiloj nje paramase profesionale dhe ne

perputhje me kerkesat dhe prioritetet reale te Komunes se Gjakoves, te merr ofert reale dhe konkuruese e profesionale ne kete procedur prokurimi.

Demet materiale jane te medhe, duke patur parasysh se keto kritere pamundesojne konkurimin e Sire. Dekurajimi i te gjithe te rinjeve te punesuar jo vetem ne kompanin tone por edhe ine gjere

KRITERET PËR VLERËSIM

	5.5		
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses referenca të cilat dëshmojnë se ka kryer shërbime në projektim të ndërtimit të ulët në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 270.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Lista e kontratave të realizuara në 3 (tri) vitet e fundit, duke saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve**
		Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën e ATK-së të paktën këtë staf profesional të paraqitur në 3 (tri) vitet e fundit dhe deri me tani. - një projekt menaxher (inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës – drejtimi konstruktive apo infrastrukturë rrugore) me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 15 vite përvojë pune. - një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi konstruksion apo	**Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës**

		infrastrukturë rrugore - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 5 vite përvojë pune. - një inxhinier i diplomuar në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi arkitekturë - me përvojë pune në projektim, së paku 5 vite përvojë pune. - një inxhinier të diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi hidroteknike - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 5 vite përvojë pune. - një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri elektroteknike - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 5 vite përvojë pune. - një inxhinier i gjeodezisë ose bachelor i inxhinierisë së ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi gjeodezi me përvoje pune profesionale minimum 5 vite; - një bachelor të ndërtimtarisë drejtimi konstruksion apo infrastrukturë rrugore - me përvojë pune profesionale minimumi 5 vite; - një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi infrastrukturë rrugore - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 1 vite përvojë pune. **Personeli shtesë për këtë projekt**	

		- një master i biologjisë (ose të ngjashëm), i licencuar për VNM (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis) nga MMPH (nga viti kaluar i lajmëruar në ATK te ofertuesi) - inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit) – i certifikuar për projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese, i certifikuar për auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC. Përvoja e punës ti përgjigjet pozicionit 16 dhe 17 të paramasës. Përvoja e kërkuar së paku 5 vite (me kontratë origjinal të bashkangjitur edhe letërnjoftimin ose kontratë te noterizuar)	
		Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO - ISO 9001 2015- Sistemi i Menaxhimit të Kualitetit - ISO 14001 2015- Sistemi i Menaxhimit Mjedisor	Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO valide- (kopje)
		Operatori Ekonomik duhet të ketë licencë të softuerit për projektim të projekteve në ndërtimin e ulët.	Licencë të softuerit për projektim të projekteve në ndërtimin e ulët.
		Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën një instrument GPS për matje gjeodezike- Instrumenti duhet të jetë i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike	Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën një instrument GPS për matje gjeodezike- Instrumenti duhet të jetë i kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike – të dëshmohet me certifikatë të kalibrimit - të dëshmohet me faturë të blerjes.

		Operatori Ekonomik duhet te ketë zyre ne zonën urbane te qytetit te Gjakovës	**Operatori ekonomik duhet te ketë zyre ne zonën urbane te qytetit te Gjakovës, te dëshmohet me kontrate për qiramarrje apo me certifikate te pronësisë nëse operatori ekonomik është pronar i lokalit.**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PER REFUZIM)

Meqë Operatori Ekonomik " **SIB-BKA** " **SH.P.K, ka parashtruar** kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët, me Nr. të Prok: 632-20-1101-2-1-1,** Nr. Brendshëm **632-003-211.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.04.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues, duke kerkuar qe i gjithe stafi - menagjeri perfshi dhe gjashte inxhinier te jene te paraqitur ne ATK (i punesuar prane ofertuesit minimum tre vitet e fundit!?) shkel ligjin e prokurimit ne nenin 1, 6 dhe 7, duke krijuar kushte per konkurrence jolojale, dhe duke ngushtuar aftesine konkurruese permes kushteve te cilat nuk ndihmojne ne marrjen e sherbimeve kualitative. Nese inxhinieret kane qene te punesuar ne ndonje kompani tjeter dhe kane pervojen e mjaftueshme pse mos te kerkohet deshmia e te njetit-qofte edhe permes paraqitjes ne ATK ne kompanin ku ka ushtruar profesionin me heret, por jo detyrimisht i punesuar tre vitet e fundit te ofertuesi!? Sa i perket kerkeses: *nje betche/or te ndertimtarise drejtimi konstruksion apo infrastrukture rrugore - me pervoje pune profesionale minimumi 5 vi/e; nje inxhinier i diplomuar ose master ne inxhinieri to ndertimil dhe arkitektures drejtimi infrastrukture rrugore pervoje pune ne projektim te ndertimil te u/et se paku Jvite pervoje pune. AK eshte ne kundershtim me vetveten. nuk mund te kerkohet i punesitar ne kompani tre vitet e fundit ndersa pervoja e kerkuar eshte 1 vite pune?*

AK. sa i perket kesaj kerkese eshte ne kundershtim me vetveten. Nuk mund te jete i paraqitur ne ATK ne tre vitet e fundit nje punetore profesional i cili e ploteson kriterin e kerkuar me me se paku 1 vite pervoje pune!
Njekohesisht, bazuar ne ligjet e aplikueshme ne Kosove, punesimi i eksperteve te jashtem eshte i lejuar, duke themeluar mardhenje pune me afat te caktuar. Autoriteti Kontraktues limiton shfrytezimin e mundesive reale dhe ligjore per plotesimin e keti kriteri. Pra, keto kerkesa te AK jane diskriminuese dhe tendencioze per pershtatje te OE te caktuar paraprakisht pa asnje dyshim!!!

Kerkojme nga AK, ne kuader te kesaj kerkese per rishqyrtim te kritereve, te hiqet kushti qe i gjithe personeli te jene te paraqitur ne ATK e sidomos tre vitel e fundit vetem te ofertuesi, Te shtohet — per stafin qe nuk eshte i punesuar tek ofertuesi mund te paraqitet marreveshje punesimi mes paleve (rne garanci te tjera shtese nese eshte e nevojshnte), duke permendur emrin dhe numrin e procedures sc prokuri m it.

Përgjigjel 1: Ne si AK, jemi duke kërkuar të lidhim kontratë me operatorë apo grup të

operatorëve të cilët përveç tjerash, ofrojnë staf të kualifikuar dhe me përvojë profesionale, një ndër dëshmitë e cila tregon se OE apo Grupi i OE ka staf profesional dhe me përvojë profesionale në projektim të ndërtimi të ulët është lista e ATK-ës për tre vitet e fundit. Ndërsa ju njoftojmë se sa i përket kërkesës për - një inxhinier i diplomuar ose master në inxhinieri të ndërtimit dhe arkitekturës drejtimi infrastrukturë rrugore - me përvojë pune në projektim të ndërtimit të ulët së paku 1 vite përvojë pune, është kërkuar përvoja 1 vjeçare për arsye se dega infrastrukturë rrugore e nivelit master është e re prandaj nuk ka staf te kualifikuar qe ka mbi 5 vjet përvojë pune (mund te këtë staf te tille qe kanë kryer jashtë vendit para vitit 2015, mirëpo e kemi konsideruara që janë të rrallë).

Po ashtu ju njoftojmë se nuk është kërkuar i gj ithë stafi të jetë pjesë e listës së ATK-ës për tri vitet e fundit, përjashtim këtu është stafi shtesë i cili është më specifik, bëhet fjalë për ekspertin e licenuar me VMN dhe inxhinierin e trafikut.

Pretendimi 2

Personeli shtese per kete projekt

nje master i biologjise (ose to ngjashem). i licencuar per VNM (Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis) nga MMPI-I (nga viti kaluar i lajmeruar ne ATK te ofertuesi)

inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit) — i certifikuar per projektim te udhekryqeve me sinjale ndricuese. i certifikuar per auditim te sigurise rrugore sipas direktives evropiane 2008 96 EC. Pervoja e punes ti pergjigjet pozicionit 16 dhe 17 te paramases. Pervoja e kerkuar se paku 5 vite (me kontrate origjinal te bashkangjitur edhe leternjoftirnin ose kontrate te noterizuar)

Eshte per to habitur qe edhe te personeli shtese u desh nje specifikim i till! Se pail nje master i biologjis (ose te ngjashem) i licencuar per VMN. por jo tre vitet e fundit ne ATK por nga viti i kaluar! Kjo nuk eshte asgje me shume as me pak se sa pershtatje per Operator Ekonomik te caktuar dhe diskriminim te OE te tjere. Kerkesa e till ne FDT ngushton edhe me shume mundesin konkuruese pa ndikuar ne marrjen e sherbimeve cilesore!

Ndersa, kerkesa e specifikuar inxhinier i diplomuar ose master i trafikut rrugor (komunikacionit), nuk mjafton per AK por duhet edhe certifikim per projektim te udhekryqeve me sinjale ndricuese! Nuk mjafton me Iraq por duhet te jete dhe i certifikuar per auditim te siguris rrugore! **Vlen te theksohet ky lloj certifikimi i kerkuar akoma nuk behet ne Republiken e Kosoves.** Kjo nuk eshte **asgje** me shume as me pak se sa pershtatje per Operator Ekonomik te caktuar dhe diskriminim e OE te tjere. Kerkesa e till ne FDT, ngushton edhe me shume mundesin konkuruese pa ndikuar ne marjen e sherbimeve cilesore! Vlen te theksohet se kv ekspert mund te jete me kontrate dhe leternjoftim (sepse kete ekspert OE i favorizuar me keto kushte nuk e ka ne listen e ATK-se as per nje vit sic e ka ekspertin me VMN), kjo eshte aq e thjesht per ta kuptuar!

Përgjigje 2: Sa i përkatë pretendimit tuaj për ekspertin e licencuar me VNM. ju njoftoj se ai/ajo mund të paraqitet si staf shtesë i kontraktuar për këtë projekt. Pra nuk ka nevojë që të jetë detyrimisht pjesë e listës së ATK-ës (pretendimi i juaj është i bazuar dhe e konsiderojmë si lëshim nga ana jonë, një sqarim i tillë i është dhënë një tjetër operatori që ka kërkuar sqarime). Sa i përkatë pretendimit tuaj për inxhinierin e diplomuar ose master i trafikut rrugor

(komunikacionit), ju njoftoj se Inxhinieri i trafikut rrugorë i cili është kërkuar. përveç shkoll imit të nivelit master dhe përvojës së paku 5 vjeçare duhet të jetë i licencuar edhe si auditor i sigurisë rrugore, kjo për faktin se në pikën 17 të paramases kërkohet ''Auditimi i sigurisë rrugore te rrugëve dhe objekteve në rrugë", një shërbim të tillë mund ta kryen vetëm auditori i licencuar për siguri rrugore. AK ka në planë që duke u mbështetur në direktiven evropiane 2008 96 EC, të kryen auditimin e sigurisë rrugore për rrugët komunale, një raport i tillë na shërben për krijimin e një strategjie për ngritjen e nivelit të sigurisë rrugore. Po ashtu ky inxhinier na duhet që të ketë dëshmi (certifikatë) e cila tregon se ka aftësi dhe njohuri të dëshmuar në projektimin e udhëkryqeve me sinjalizim ndriçues (semaforë). AK ka në planë qëtë analizoj tërë rrjetin rrugorë dhe udhëkryqet e caktuara duhet të projektohen me sinjalizim me ndriçim (semaforë). Për shkak të keqpërdorimeve të diplomave, licencave kemi kërkuar si dëshmi shtesë kopjen e letëmjoftimit ose kontrata e noterizuar.

Autoriteti Kontraktues ka kerkuar ne kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, 9.1 & 9.2

Operatori Ekonomik duhet te kete te pakten nje iustrument GPS per matje gjeodezike-Instrument! duhet te jete i kalibruar dhe ne gjendje to rregullt teknike.

Pretendimi 3. Kerkesa per paisjet gjeodezike mend te mbulohet nga nje kompani projektuese nga nje nenkontraktor qe merret sepcifikisht me pune gjeodezike e ka bashkepunim sa i perket sherbimeve gjeodezik.

Prandaj, kerkesa sa i perket ketyre paisjeve duhet te modifikohet sepse mend te plotesohet me nje nenkontraktor.

Përgjigje 3: Sa i përketë pretendimit tuaj për instrumentin GPS per matje gjeodezike, ju njoftoj se mund të kontraktohet një kompani (operatorë) që ofron një shërbim të tillë dhe i cili ka të paktën një instrument të kalibruar dhe në gjendje të rregullt teknike ashtu siç është kërkuar në FDT.

Operatori Ekonomik duhet te kete zyre ne zonen urbane te gytetit te Gjakoves.

Pretendimi 4: Sa i perket kerkeses se AK, qe OE detyrimisht te kete zyre ne zonen urbane te Gjakoves sa eshte e pakuptimt, tendecioze dhe shume e turpshme. Kur bota sot dhe teknologjia e kominikimit ka arritur nivelet me te luta qe ka njohiir njerzimi deli sot Komuna e Gjakoves detyron nje ndermrrje Projektuese profesionale te kete zyre dhe ate vetem ne zonen Urbane te qytetit! Nese duhen takime fizike e gjithe Kosova, maksimumin e arritjes prej cilit do vend te Kosoves ne Gjakove e ka nje ore e tridhjel minula. Cili eshte qellimi i kesaj kerkese te AK!?

Pergjigje 4: Për shkak të volumit të punës që kërkohet të kryhet nga projektuesit dhe për shkak të kontrol I it sistematik (nga komisioni i kontratës) të fazave projektuese, na duhet që operatori të ketë zyrë brenda zonës urbane në mënyrë që të shërbej si kabinet pune për projektuesit dhe komisionin e pranimit.
Ju njoftojmë se kontrata për qira marrje për zyrën në fjalë, është e pranueshme edhe nëse lidhet

me kusht që të filloni shfrytëzimin e zyrës pas nënshkrimit të kontratës me AK.
Për shkak të ngritjes së shqetësimit për këtë pikë që kemi pranuar deri më tash nga katër operatorë dhe duke u mbështetur në kufizimin e lëvizjes për shkak të gjendjes së pandemisë, në mënyrë që operatorët (të cilët kanë selinë jashtë Komunës së Gjakovës) mos të obligohen që të lëvizin për të lidhur kontrata me poseduesit e zyrës në zonën urbane të Gjakovës, Njësia e kërkesës i ka rekomanduar zyrës së prokurimit që kjo pikë të ndryshohet duke shtuar se vlen vetëm për operatorin fitues të këtij aktiviteti.

Përgjigje 5: Sa i përketë pretendimit tuaj për termin Ri-projektim, ju njoftojmë se ky pozicion nënkupton ri-projektimin e projekteve ekzistuese që AK posedon. pra në rastet kur kërkohet që projektet ekzistuese të ndryshohen, shfrytëzohen këto pozicione, ju duhet të ofertoni për ri-projektimin e projekteve që AK ka në dispunueshmëri (të deponuara).
Dallimi në mes të rrugëve me dy, tre apo katër shirita të qarkullimit për zonën urbane dhe rurale dallon në thelb sa i përket kompleksitet të punës apo projektimit, p.sh. një rrugë në zonën urbane kërkon punë më të madhe për projektim për shkak të problemeve pronësore, analizës së qarkullimit, trajtimi i objekteve, përmbajtjes së planeve rregulluese urbane etj. Ndërsa në zonën rurale projektimi është më pak kompleks. E njëjta përgjigje vlen edhe për kanalizimet edhe ujësjellësin, prandaj është ndarë në dy zona.
Sa i përketë dallimit në mes të projektimit te urave me gjatësi deri në 10 m dhe mbi 10 m, dallimi është tek volumi i punës gjatë projektimit, ura deri në 10 m ka volum më të vogël të punës në projektim se sa ura mbi 10 m.
Sa i përketë pozicionit 13 dhe 16, ju njoftojmë se pozicioni 13 ka për qëllim që të projektohen udhëkryqet e të gjitha llojeve me përjashtim të udhëkryqit me sinjalizim ndriçues, sa i përketë pretendimit tuaj për njësi matëse konsiderojmë se është i bazuar dhe është një lëshim nga ana jonë njësia matëse për këtë pozicione duhet të jetë copë, e jo m'.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KËRKUARANGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "D&T Group & Florida"

Përgjigje në pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin ankimorë kundrejt kërkesës së AK-së që OE duhet të ketë në listën e ATK-së për stafin professional për tri vitet e fundit, vlerësojmë se është kërkesë e cila do të kufizonte pjesëmarrjen e OE-ve të mundëshëm në kudnërshtim me nenin 7 pika 6 të LPP-së.

Vlerësojmë se është në diskrecion të AK-së të kërkohet përvojëa e punës për stafin profesional relativ me natyrën e këtij projekti, mirëpo jo përmes listës së ATK-së të operaorit ekonomik, sepse kështu do të eliminoheshin të gjithë OE-të që kanë staf profesional të punësuar më shkurt se tri vite në kompaninë e tyre, pavarsisht përvojës shumvjeqare që mund të ketë po i njëjti stafi. Konsiderojmë se jë kërkesë e tillë mund të dëshmohet edhe përmes dokumenteve tjera si CV, kontrata/referenca të punës etj.

Po ashtu kjo kërkesë do të pamundësonte OE-ve që të angazhojnë staf të veqantë me qëllim të realizimit të këtij projekti pavarsisht përvojës shumëvjeqare që mund kenë ata persona.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë kundrejt kërkesës së AK për kualifikimet dhe përvojën e personelit shtesë, Master I biologjisë I licencuar për VNM(Vlersimi Ndikimit në Mjedis), inxhjinier master I diplomuar I trafikut "*i certifikuar për **projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese**, i certifikuar për **auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC**. Përvoja e punës ti përgjigjet pozicionit 16 dhe 17 të paramasës. Përvoja e kërkuar së paku 5 vite (me kontratë origjinal të bashkangjitur edhe letërnjoftimin ose kontratë te noterizuar).*".

Siq e cekëm më lartë vlerësojmë se është në diskrecion të AK-së të caktoj përvojën dhe kualifikimet e stafit, me gjithë këtë mendojmë se të kërkohet nga I njejti inxhinier të jetë i *certifikuar për **projektim të udhëkryqeve me sinjale ndriçuese**, i certifikuar për **auditim të sigurisë rrugore sipas direktivës evropiane 2008 96 EC*** do të ngushtone pjesëmarrjen e OE-ve.

Lidhur me këtë kërkesë vlerësojmë se AK do duhej lejuar së paku që për këto dy certifikime të lejohet plotësimi përmes dy personave/inxhinierve të ndryshëm, e jo të kufizohen që dy certifikimet nga I njëjti person/inxhinier.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.3

Sa i përket kërkesës së AK-së që OE të ketë në proënsi GPS të kalibruar, në kërkesë për rishqyrtim AK janë pajtuar se kjo kërkesë mund të plotësohet edhe përmes nënkontraktorit.

Përgjigje në pretendimin nr.4

Lidhur me kërkesën e Ak-së që OE duhet të ketë zyre në zonën urbane të qytetit të Gjakovës, vlerësojmë se është kërkesë diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 pika 4 të LPP-së. Kjo dispozitë ligjore shprehimisht e ndalon krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr.5

Sa i përket pretendimit ankimorë rreth paramasës së caktuar nga AK, OE ankues pretendon se disa pozicione janë të panevojshme dhe krijojnë mundësi manipulimi me cmime për OE-të.

Lidhur me këtë pretendim AK pjesërisht janë pajtuar sa i përketë njësisë matëse për një pzicion, si dhe në kërkesë për rishqyrtim kanë dhën arsyetim detal pse paramasa është dhenë si e tillë, e po ashtu kanë theksuar edhe dallimet në mes të pozicioneve që në dukje të parë mund të jenë të ngjashme.

Vlerësojmë se caktimi i nevojave dhe paramasës janë në diskrecion të AK-së.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazar, ndërsa të anulohet njfotimi për kontratë i AK-së, dhe nëse AK ka ende interes për zhvillim të këtij aktiviteti të prokurimit lëndën ta kthej në ritender duke bërë korrigjimin e dosjes së tenderit në pajtim me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK Gjakovë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues –SIB- bka